



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 03 maj 2017, në mbledhjen e XLI-të (dyzetënjë) të Kuvendit të Komunës.

Mbledhja filloi në orën 10;10 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesues Kuvendit.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit, përveç z.Fidan Rekalio dhe z.Xhevdet Beselica të cilët munguan. Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje të pranishëm ishin, drejtorët e Drejtorive të Komunës, z.Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE - së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, fillimisht seancën e hapi duke përshëndetur të pranishmit dhe duke iu dëshiruar mirëseardhje. Konstatoi prezencën ku fillimisht për z.Fidan Rekalio tha se mungon me arsye ndërsa znj.Endritë Murati, znj.Florije Maliqi dhe z.Xhevdet Beselica për momentin nuk janë prezent por të shohim në vazhdim të mbledhjes se a do vijnë apo jo.

z.Nexhat Llumnica, theksoi, ne si Grup i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës kërkojmë të përfaqësohemi në komisionet përkatëse që na takojnë sikurse çdo subjekti tjetër të këtij Kuvendi.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, edhe pse tani më veç është fundi i mandatit, ne është mirë të takohemi së bashku me shefat e Grupeve të këshilltarëve dhe pastaj në mbledhjen e ardhshme të KPF-së mund të vij njëri prej përfaqësuesve të AAK-së dhe mund të diskutojmë për mundësitë që parafolësi i paraqiti.

z.Avni Ajeti, theksoi, sigurisht jeni në dijeni se unë jam anëtar përkatësisht kryesues i komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, andaj nëse pajtoheni të jem ende në atë pozitë unë jam i gatshëm të vazhdoj, nëse jo unë gjithashtu jam i gatshëm të jap dorëheqje. Njëherit ju falënderoj për besimin që ma keni dhënë në lidhje me këtë çështje por si do që të jetë ju mund të vendosni sërish se a mund apo jo ta kryej atë punë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ajo që e potencova paraprakisht besoj që vlen edhe për këtë çështje të ngritur nga parafolësi. Prandaj mund të vazhdojmë me punë, konsideroj se thirrja dhe materiali i propozuar i ditës ju është dërguar me kohë, ndërkohë është paraqitur edhe një kërkesë tjetër për përfshirje në rend të ditës e cila është shqyrtuar në mbledhjen e KPF-së dhe i është rekomanduar Kuvendit që në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje të përfshihet edhe ajo kërkesë - propozim vendim të cilin mund

ta shihni edhe në konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e KPF-së. Gjithashtu ju njoftoj se në bazë të legjislacionit në fuqi, deri më 15.05.2017 mund të marrim vendime për dhënie të pronave komunale në shfrytëzim afatgjatë andaj rreth këtij propozimi ne mund ta shfrytëzojmë këtë afat dhe ta mbështesim atë kërkesë e cila është në interes të banorëve të asaj ane. Meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë pikën shtesë dhe konstatimet nga mbledhja e KPF-së e mbajtur një ditë më parë.

Pas votimit u konstatua se me 28 vota për, asnjë votë kundër dhe 3 vota të përmbajtura u miratua rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe konstatimet e rekomanduara nga mbledhja e Komitetit për politikë dhe Financa si dhe pikën shtesë, përkatësisht në pikën 7 rendit të ditës, përfshihet,

- **Propozimin e vendimit për dhënie të pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS.**

Ndërsa pika Të ndryshme kalon në pikën 8

2. Ekstraktet e Procesverbaleve nga mbledhjet e Kuvendit të Komunës e mbajtura më 07 mars 2017 dhe 31 mars 2017

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratuan;

-Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 07 mars 2017, dhe

-Ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më 31 mars 2017

3. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës, për periudhën janar – mars 2017

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, fillimisht e ftoj drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave të paraqesë një fjalë hyrëse rreth kësaj pike.

z.Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave (DBF), e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, para vetës kemi një raport i cili është edhe obligim ligjor të silltet dhe shqyrtohet në Kuvendin e Komunës, raport i cili për qëllim ka prezantimin e një pasqyre të aktiviteteve financiare të zhvilluara në periudhën janar – mars 2017, të cilat do t'i paraqesë në vazhdim, përkatësisht shpenzimet të cilat kanë ndodh sipas kategorive dhe kodeve ekonomike si dhe sipas burimeve prej nga ato janë shpenzuar duke bërë edhe një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Shpenzimet e buxhetit për këtë periudhë arrijnë shumën totale 3,246,969.00€, dhe atë për paga dhe mëditje 2,870,413.00€, mallra dhe shërbime 71,153.00€, shpenzime komunale 61,359.00€, subvencione 44,011.00€, si dhe investime kapitale 200,033.00€ e që shprehur në përqindje është 17% e buxhetit të planifikuar, mjete të cilat janë shpenzuar në kuadër të planifikimit për këtë periudhë dhe nëse bëjmë krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak vërehet një zvogëlim i shpenzimeve prej 2%. Sa i përket planifikimit dhe realizimit të të hyrave vetanake për këtë periudhë janar – mars 2017 shuma e inkasuar është 306,419.00€ ose 17% e planit vjetor e që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016 kemi një ngritje afërsisht 4%, pa përfshirë shumën prej 2,000.00€ e hyrë vetanake nga donatorët e jashtëm. Karakteristikë e këtij raporti është se të hyrat janë rritur prej 4% kurse

te shpenzimet kemi një zvogëlim prej 2% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, zvogëlim i cili është shfaqur tek shpenzimet operative ndërsa ngritja është bërë nga pagesat për investime kapitale. Për fund mund të konstatojmë se ky raport financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – mars 2017 jep një pasqyrë të qartë të të hyrave dhe të dalave për këtë periudhë raportuese.

Kryesuesi i Kuvendit, *njoftoj për ardhjen e dy këshilltareve të Kuvendit, znj.Endritë Murati dhe znj.Florije Maliqi.*

z.Hasan Softolli, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e mbështetë raportin financiar të Komunës së Podujevës për periudhën janar – mars 2017 i përpiluar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, raport i cili shpalosë në detaje të gjitha informacionet e nevojshme mbi aktivitetet e Ekzekutivit të Komunës duke përfshirë edhe krahasimet me periudhën e njëjtë të vitit 2016. Gjatë analizave të bëra të këtij raporti, ashtu siç u cek dhe u shpalosën edhe nga parafolësi drejtor i DBF, vërehen se në disa kategori kemi ngritje dhe në disa të tjera rënie të cilat më gjerësisht janë të paraqitura në raport, andaj nuk e shoh të arsyeshme të lëshohem më gjerësisht.

z.Rafet Llapashica, theksoi, ne në mbledhjen e KPF-së kemi debatuar shkurt rreth këtij raporti dhe kemi rekomanduar që kjo pikë të shkoj në Kuvend me qëllim të debatimit më të gjerë. Lidhur me disa pika të këtij raporti për të cilat do të diskutoj në vijim, konsideroj se është mirë të jenë në dijeni edhe këshilltarët tjerë sepse janë shpenzime të rëndësishme. Pagesa për shpenzime të telefonisë mobile në shumë 1129.00€, duke përjashtuar shpenzimet për telefoni fikse, ne vazhdimisht sa herë kemi pasë raporte financiare në këtë Kuvend, kemi thënë që shpenzimet e telefonisë fikse janë të arsyeshme ndërsa ato për telefoni mobile jo, për arsye se komunikimi i brendshëm institucional dhe zyrtar është pa pagesë si dhe është një marrëveshje mes operatorit Vala dhe Komunës që ne të komunikojmë mes vete pa bërë shpenzime, dhe në këtë aspekt pas diskutimit tim kërkoj nga drejtori i DBF të na tregoj se prej kujt janë shfrytëzuar konkretisht ato mbushje dhe për çka janë shfrytëzuar. Meqë komunikimi i brendshëm brenda rrjetit është pa pagesë, për çfarë arsye janë shpenzuar ato mjete për të cilat mendoj se për tremujorin e parë të vitit janë shpenzime maksimale, këtë e them duke vlerësuar minutazhin që për një minutë shpenzohen 0.04 cent ose jashtë vendit rreth 30 cent. Pra nëse për tre muaj qëndron një zyrtarë i Ekzekutivit jashtë vendi dhe ka komunikim të rregullt, nuk e arrin këtë shifër edhe pse ndoshta nuk është një shifër marramendëse por është para publike andaj edhe është mirë që së paku të njoftohemi se në çfarë forme janë shpenzuar. Për mirëmbajtje dhe riparim të automjeteve janë shpenzuar 2154.00€, vlen të theksohet se në këtë raport kam vërejtur se më i korrekti ka qenë drejtori i DSHPMSh z.Faik Muçiqi i cili ka specifikuar edhe pagesat e kompanive që janë bërë për punë të kryera dhe kjo dëshmon që nuk jemi këtu vetëm për kritika, dhe kur bëhen gjëra të mira i vlerësojmë por kur bëhen gjëra jo të mira i kritikojmë dhe kjo është normale, andaj edhe në këtë aspekt kërkoj përgjigje nga drejtori i Drejtorisë së Administratës, ku riparohen automjetet e Komunës së Podujevës, çka janë riparuar dhe cilat janë ato automjete madje specifikisht me targa të automjeteve të riparuar si dhe cila është ajo kompani që i janë paguar 2154.00€, pra këto ishin si pyetje konkrete. Gjithashtu vërejtje kam edhe për shpenzime për dreka zyrtare, e kuptoj dhe është e natyrshme që Kryetari i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive kanë delegacione të ndryshme qoftë nga jashtë qoftë mysafir të brendshëm, mirëpo duke qenë në dijeni për shpenzimet që mund të bëhen për një drekë zyrtare, por edhe jemi dëshmitarë të gjithë ne këtu se në Komunën e Podujevës nuk kemi pasë ndonjë delegacion me mbi 10 persona që do të ishte

ndoshta maksimum 10€ racion plus 2-3 pije jo alkoolike për person, mirëpo kemi shumë e shpenzuar prej 1358.00€, unë i kam kalkuluar dhe del që Ekzekutivi i Komunës është dashtë t'i ketë mbi 15 delegacione zyrtare me nga mbi 12 persona në mënyrë që të arrihet kjo shumë, prandaj për këtë kam pyetje konkrete dhe atë, në cilat takime ose në cilat vizita zyrtare janë shtruar këto dreka zyrtare, ne absolut nuk jemi kundër drekave zyrtare dhe ne si Kuvend nuk kemi pas dreka zyrtare, por sigurisht Ekzekutivi ka pasë dreka të tilla, mirëpo do të ishte mirë ashtu siç ka vepruar drejtori z.Faik Muçiqi të veprohej edhe me këto shpenzime për dreka zyrtare dhe ne pastaj absolut do ta kalonim më mirë këtë pikë. Si vërejtje ndoshta do të ishte edhe për shkak të mjeteve që është dashtë të investohen, të gjithë e kemi parasysh se ka qenë sezoni dimri janar-mars dhe dinamika e punimeve është me një intensitet më të ulët edhe pse e kemi të qartë se ky vit është elektoral dhe investimet dinamizohen politikisht, mirëpo para se të vie ky raport financiar është dashtë të specifikohen shpenzimet me qëllim që të mos marrim minuta mes vete duke debatuar këtu në këtë Kuvend. Pra kalkulimet e mia të llogaritura dalin që Kryetari i Komunës është dashur t'i ketë së paku 10 delegacione zyrtare me nga mbi 12 persona për të dal në dreka në restorantet më të shtrenjta në Komunën e Podujevës për tu arrit kjo shumë, ndërsa unë jam në dijeni se kjo nuk ka ndodh dhe nuk ka pasë vizita të tilla zyrtare dhe së paku nuk kanë qenë as mediatike, e që ka të bëjë edhe me pikën vijuese lidhur me transparencë.

z.Bahri Selimi, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje si zakonisht edhe këtë raport financiar e ka shqyrtuar dhe paraprakisht është evidente që pa hezitim e them që sikurse çdo raport tjetër paraprak ka plot të meta në kuptimin e përgjithshëm për shkak të realizimeve të mjeteve në këtë periudhë tremujore. Fillimisht në sy bie kategoria e investimeve kapitale që është një investim shumë i ulët prej rreth 200,000.00€ në krahasim me pagesat tjera që janë bërë në shumë mbi 180,000.00€, pa dashur të përmend kategorinë për paga dhe mëditje sepse shumë herë është thënë se ato mjete janë të destinuara vetëm për këtë vijë buxhetore dhe nuk mund të destinohen, mirëpo krejt ajo që më bie në sy janë investimet kapitale që ne mendojmë se shuma e shpenzuar është shumë e vogël. Nëse diskutojmë për kode, ne shumë herë po flasim për shpenzime të mëdha që bëhen me mjete të ndryshme, por një ndër ato që mua më bie në sy si e metë është për furnizime pastrimi ku për këtë tremujorë nuk figuron asnjë shpenzim, ndërsa në qoftë se nisemi nga kjo sallë e këtij Kuvendi që jemi, pastaj prej objektit të Komunës, në objektet shkollore, në objektet shëndetësore unë mendoj se jo që është dashur të shpenzohen shumë mjete në këtë kod por ndoshta është dashur të bëhen shpenzimet më të mëdha të mjeteve. Mirëmbajtja e automjeteve gjithherë ka qenë një mister në vetë, ashtu po e quaj, dhe asnjëherë nuk është dhënë ndonjë specifikë e saktë rreth mirëmbajtjes së automjeteve dhe shumave të shpenzuara për mirëmbajtjen e tyre. Po ashtu kësaj radhe si befasi për dreka zyrtare është shpenzuar një shumë e madhe dhe për këtë jam shumë kurioz ta dijë se a ka ose a është ndjellë ndonjë investim përkundër këtyre shpenzimeve kaq të mëdha në shumë 1358.00€, gjë për të cilën parafolësi e bëri një krahasim ku mori shembull një racion 10€, por unë e them se më shumë se 7€ nuk ka dhe nëse e bëjmë një kalkulim të thjeshtë duke pjesëtuar i bie që janë ngrënë 194 dreka zyrtare apo 3 dreka në ditë, po që se çdo ditë të kishte nga një delegacion dhe kryetari të shkonte me dy zyrtar tjerë plus delegacioni nuk do të arrihej kjo shumë, mirëpo me që nuk jam në dijeni për numrin e pjesëmarrësve në delegacione nuk po e zgjati më shumë me këtë lloj misteri që po e quaj. Gjithashtu çështje e cila më bie në sy janë kompanitë të cilat po kryejnë punë në Komunën e Podujevës, çështje të cilën e kemi ngritur edhe më parë, që do të thotë se

kompanitë në Komunën e Podujevës janë gjithherë të njëjtat që janë punëkryese dhe që ju bëhen pagesat, andaj unë sërish e potencoj se favorizimi i kompanive është prap një çështje e cila nuk po anashkalohej asnjëherë, e them këtë sepse sipas këtij raporti nga 183,160.00€ del që 155,271.00€ ose 84.77% ju kanë paguar vetëm dy kompanive ndërsa pjesa tjetër e pagesave ju janë bërë 8 kompanive tjera, dhe në këtë aspekt nëse vetëm pak i shikojmë këto statistika del gjithherë që favorizimi i kompanive që kryejnë punë është paksa i tepërt por edhe përkundër kësaj megjithatë unë uroj që punët të kryhen mirë dhe mos të paraqiten probleme siç ishin më parë me asfalt dhe me kanalizime sepse në këto dy fenomene janë investimet më të mëdha.

z.Nexhat Lumnica, theksoi, edhe përkundër asaj që ky raport është tremujor dhe koha është e shkurtër besoj që ka të mirat e veta por edhe ne i kemi vërejtjet tona të cilat nuk dëshiroj t'i përsërisë sepse janë të ngjashme me ato të parafolësve, ndërsa uroj që raportet tjera të ardhshme financiare të jenë më në rregull ashtu siç i ka hije të jenë raportet financiare në vendet demokratike.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural z.Avni Fetahu, përse kaq pak subvencione në këtë pranverë. Edhe parafolësit e thanë që nuk është punuar mjaftueshëm por fundja kur ka shpenzime më shumë se sa punë do të thotë që shpenzimet janë bërë pa punë ose nuk është punuar fare.

z.Fatmir Gashi, drejtor i Drejtorisë së Administratës (DA), theksoi, sa i përket shpenzimeve për telefoni mobile, janë shpenzime të ndara nga 20€ mbushje në muaj për Ekzekutivin e Komunës, ndërsa sa i përket shumës së shpenzuar për mirëmbajtje të automjeteve, fjala është për të gjitha automjetet zyrtare të Komunës së Podujevës duke përfshirë edhe ato të QKMF-së dhe Shërbimit të zjarrfikjes, tani për tani nuk kam këtu specifikacion veç e veç mirëpo sigurisht që në ndonjë seancë tjetër të radhës do t'ju ofroj specifikacionin dhe arsyeshmërinë përkatëse. Pastaj ishte pyetja, përse nuk është shpenzuar fare për mirëmbajtjen dhe pastrimin e objekteve, ju njoftoj se jemi në fazën e pagesës dhe verifikimit të shpenzimeve të mjeteve për furnizime pastrimi. Mirëmbajtja nuk po e them që është e duhur por megjithatë funksionon.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR), theksoi, pati pyetje rreth kësaj Drejtorie, unë mund t'ju them se projekti i serrave është në fazën finale të vlerësimit të kontratës, pastaj në përfundim e sipër është edhe projekti për certifikimin e Global GAP, mandej projekti për sistemin e ujitjes, andaj sigurisht që pas realizimit të këtyre projekteve, në raportet e ardhshme do të figurojnë edhe shpenzimet e ndodhura në sektorin e bujqësisë.

Pra e them se kemi tri projekte të cilat janë në fazën përfundimtare të realizimit.

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mbrojtjes së mjedisit (DSHPMSH) theksoi, dëshiroj të them disa fjalë rreth dinamikës së investimeve kapitale pa përjashtuar edhe shpenzimet tjera. U përmend edhe nga parafolësit që tremujori i parë nuk ndikon shumë në investime kapitale për shkak të kohës dhe natyrës së projekteve, por megjithatë nga këto 200,000.00€ sa janë shpenzuar për këtë kategori, nga DSHPMSH janë 158,000.00€ për projekte kryesisht dyvjeçare të cilat kanë pasë kontrata dhe të cilat kanë vazhduar, posaçërisht me trotuare dhe kanalizime, ndërsa një shpenzim në shumë 3281.00€ është kryer dhe që ka qenë i vetmi borxh, ndërsa të tjerat janë paguar sipas punëve. Mendoj se me dinamikën e investimeve si Drejtori qëndrojmë mirë dhe jemi në fazën e përgatitjeve që investimet të kryhen me kohë kryesisht gjatë verës si dhe

shpresojmë që buxheti të mos konsiderohet vetëm i shpenzuar por të kryhen punët ashtu siç kërkohen sipas projekteve.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, dëgjova me vëmendje përgjigjet e drejtorëve parafolës, mirëpo dëshiroj ta pyes, mbi cilën bazë dhe me cilin akt është e rregulluar pagesa prej 20€ për telefoni mobile për drejtorët e Drejtorive, nuk është ndonjë shpenzim i madh por pagesa kur bëhet duhet të jetë e përcaktuar ndokund dhe duhet të ketë bazë. Çështja tjetër është, mu duk paksa e paarsyeshme kur një drejtor parafolës e tha që nuk i kam me vete dokumentacionet përkatëse për të dhënë përgjigje dhe sqarime, por unë mendoj që nëse vjen në seancë dhe dëshiron të përgjigjesh në pyetjet e këshilltarëve të Kuvendit duhet të jesh i përgatitur për çdo pyetje që lidhet me performancën e vendit përkatës të punës, kontratës së punës dhe obligimeve ligjore që i ka një drejtor i një Drejtorie, pra ne i bëjmë pyetjet ndërsa drejtori duhet t'i dinë të gjitha për ta mbajtur atë vend pune. Pastaj rreth mirëmbajtjes së automjeteve, të gjithë ne jemi në dijeni për cilat automjete dhe cilave sektor bëhet fjalë, por pyetja konkrete ishte, cilat janë ato automjete, qoftë të administratës së Komunës, qoftë të QKMF-së qoftë të zjarrfikësve, çfarë defektesh kanë pasur etj. Pyetje konkrete është, t'i si drejtor a keni futë në tender, cila kompani mirëmban automjetet zyrtare të Komunës, dhe kujt i bëhen pagesat, pra nuk është problemi i pagesës në shumë 2000.00€, por specifikisht të njoftohemi kujt i janë paguar dhe për çka, shembull siç e kemi tek DSHPMSH ku thuhet ku thuhet kompania "Bini" është paguar 20,000.00€ për këtë punë, duke specifikuar punimet. Edhe njëherë e përsërisë pyetjen konkrete, kush i mirëmban automjetet zyrtare të Komunës së Podujevës, apo rregullohen ku të munden, ku është paguar shuma mbi 2000.00€ në cilën kompani dhe cilat vetura kanë qenë me defekte, pra nëse këto gjëra nuk i dinë drejtori i Drejtorisë së Administratës, kush është fituesi i tenderit, kujt i janë bërë pagesat, cilat automjete janë servisuar etj, është defekt serioz i drejtorit sepse ai vet ka propozuar buxhet për mirëmbajtje të automjeteve dhe ne e kemi miratuar në këtë Kuvend. Kërkoj përgjigje për këto që i ceka sepse ne nuk kemi ardh këtu në këtë Kuvend vetëm sa për të thënë diçka ose të votojmë kundër, por më brengos vota për, për një qëllim politik.

z.Haki Rudari, theksoi, natyrisht që kolegu parafolës nga radhët e LVV-së i tha gjitha ato që ne kemi biseduar si Grup, por megjithatë do t'i cekë edhe unë disa çështje rreth këtij raporti financiar. Në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar për këtë raport por në një mënyrë vetë shuma e shpenzuar prej 200,000.00€ për investime kapitale nuk të lenë hapësirë për të diskutuar rreth kësaj gjendje për arsye se nga 5,472,479.00€ të investohen vetëm rreth 200,000.00€ mendoj se kjo tregon rezultatin apo suksesin e qeverisë lokale. Kërkesat e qytetarëve janë të shumta si në arsim, shëndetësi, mbrojtje të ambientit dhe në shumë sektorë të ndryshëm, si dhe gjithherë kërkesat tona nuk janë marrë për bazë nga qeveria lokale me arsyetim se nuk ka mjete financiare, dhe unë tani pyes, mjetet janë por përse nuk ka investime, mendoj se këtë dikush duhet ta merr si përgjegjësi nga qeveria lokale apo drejtorët e Drejtorive përkatëse. Ne vazhdimisht në çdo fillim vit kemi kërkuar një program qeverisës të Drejtorive komunale, për këtë çështje un kam hulumtuar dhe kam hasur në shumë komuna që e kanë planin qeverisës të Kryetarit të Komunës dhe drejtorëve të Drejtorive veç e veç, plane të cilat i kemi ne që vijmë nga fusha e arsimit dhe të cilat sigurisht që mundësojnë edhe qeverisjen por edhe investimet. Arsyetimet paraprake ishin për shkak të kohës së shkurtër, ndërsa unë mendoj se nuk qëndrojnë ato arsyetime, por janë mungesa e programeve qeverisëse dhe mungesa e projekteve dhe si pasoj e tyre tani paraqiten vonesa në tenderime dhe prokurim, andaj si rezultat i kësaj vjen edhe ky investim

prej 200,000.00€, shumë e cila thënë të drejtën është shumë shqetësuese. Ajo që unë e shoh si gjë pozitive është rritja e të hyrave vetanake prej afër 4%. Nëse hymë detaje të raportit vërejmë disa projekte të cilat vërtetë janë kontraste, deri sa në periudhën e njëjtë të vitit 2016 për ujë kemi pasë 23,121.00€ harxhime, tani kemi 9,224.00€, a thua është ndalë uji apo është zvogëluar tarifa apo përse është kjo rënie prej rreth 60%. Po ashtu indikative janë edhe shpenzimet për telefoni mobile rreth 3000.00€, disa nga këshilltarët e patën analizuar këtë gjë por një derë e një shkolle pati ndejë pa rregulluar për një kohë të gjatë madje në dimër, ndërsa tani shpenzohen shuma të mëdha për telefoni, gjë për të cilën nuk e di a i thonë rezultat pozitiv apo jo, kjo mbetet të vlerësohet nga secili. Pastaj janë shpenzuar rreth 2229.00€ për pajisje tjera më pak se 1000.00€, por nuk dihet për çfarë pajisjesh bëhet fjalë. Po ashtu furnizime pastrimi, mendoj se gjendja është jo e mirë qoftë në shëndetësi qoftë në arsim dhe kudo tjetër shihet se ka mungesë të furnizimeve për pastrim kurse mjetet janë të ndara por që nuk shpenzohen. Për mirëmbajtje e rrugëve lokale kemi 913.00€ dhe nuk di çka i themi kësaj, ndërsa gjendja e rrugëve lokale dhe në disa lagje është tejet e rëndë dhe për këtë çështje besoj se ka pasë edhe shumë kërkesa nga banorë të lagjeve të ndryshme për zhavorr dhe asfalt. Objekte shëndetësore 23,742.00€ por a mund ta dimë cilat janë ato objekte dhe ku janë ato objekte, e them këtë për arsye se sipas informatave që kam mungesat janë të mëdha në këtë drejtim dhe se qytetarët kanë kërkesa të mëdha. Gjithashtu edhe një çështje që dua ta shtroj në formë të pyetjes është pagesa për përfituesit individual ku kemi një rritje nga 5000.00€ në 10,371.00€ apo 107.44%, prandaj të gjitha këto tregojnë se vërtetë është një raport financiar në kuptimin ligjor por nëse hymë në detaje vërtetë del se është shqetësues andaj për ne LVV-në është i papranueshëm.

z.Faik Muçiqi, theksoi, dëshiroj të jap disa sqarime rreth çështjeve që u ngritën nga parafolësi z.Haki Rudari, meqenëse sërish kjo çështje po ndërlihet me dinamikën e investimeve e që nuk mendoj se është shqetësuese dhe nuk është mungesë e projekteve ashtu siç u tha, pra nuk mund të thuhet se brenda këtij tremujori nuk keni realizuar disa projekte për shkak të mungesës së projekteve sepse projektet janë miratuar në Kuvendin e Komunës për secilën Drejtori ndërsa sa do të realizohen deri në fund të vitit është diçka tjetër, mirëpo të thuhet në fillim vit se ka mungesë të projekteve konsideroj se është pak sa jo serioze sepse ky Kuvend ka miratuar ato projekte të cilat në fakt ekzistojnë dhe të cilat i kemi në planin e punës për investime dhe nuk kemi diçka tjetër përveç asaj që është miratuar në Kuvend. Çështja tjetër, ka shumë punë të cilat janë duke u punuar por pagesat nuk janë ekzekutuar brenda këtij tremujori. Mund të them se vetëm brenda DSHPMSH janë duke u punuar rreth 7-8 projekte por pagesat nuk janë bërë në këtë tremujor, prandaj dua të them se nuk është shqetësuese dinamika e investimeve dhe nuk kemi mungesë të projekteve brenda Drejtorive.

z.Haki Rudari, theksoi, nga drejtori parafolës u tha se nga shumica e këshilltarëve të Kuvendit është votuar buxheti së bashku me projektet, mirëpo ne LVV-ja nuk i kemi votuar, për arsye se për mendimin tonë kanë qenë projekte jo të mira, por megjithatë ne po debatojmë për një raport financiar tremujor dhe unë gjithherë po flasë në bazë të këtij raporti, ndoshta kur të vie raporti gjashtëmujor apo nëntëmujorë do të realizohen të gjitha ato projekte që keni në planifikime, mirëpo sërish e përsërisë që përderisa kemi një raport tremujor me investime 200,000.00€, kurse nëse ju thoni që unë jam gabim, urdhëroni lexojeni këtë raport ose sillni raportet tjera. Prandaj sërish e përsëris se kjo shumë e investimeve është shqetësuese për ne.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, unë paraprakisht në diskutimet e mia pata pyetje shumë konkrete, andaj kërkoj që në procesverbal të specifikohet që nuk ka përgjigje për pyetjet në fjalë. Pra pyetjet ishin shumë konkrete për drejtorët kompetent të Drejtorive përkatëse, mirëpo nëse nuk ka përgjigje konkrete kërkoj që procesmbajtësi të futë në procesverbal zyrtar që për pyetjet konkrete drejtori adekuat nuk ka përgjigje rreth pagesave të kryera.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, çdo mbledhje e Kuvendit të Komunës, respektivisht çdo diskutim incizohet dhe përgatitet Ekstrakti i procesverbalit, edhe pyetjet e parafolësit janë të incizuara dhe drejtori i Drejtorisë përkatëse mund t'i jap përgjigjet edhe në mbledhjen e radhës, dua të them se nëse në këtë mbledhje drejtori i Drejtorisë përkatëse nuk i posedon të gjitha shënimet, përgjigjet mund t'i jap në mbledhjen e radhës, dhe për këtë edhe vet ai e mori për obligim dhe u deklarua që në mbledhjen e radhës do të jap përgjigjet përkatëse. Meqë nuk pati këshilltar tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Kuvendit e hedh në votim raportin financiar të Komunës së Podujevës për periudhën janar – mars 2017.

Pas votimit u konstatua se me 17 vota për, 15 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – mars 2017.

4. Propozimi i Planit të veprimit për transparencë në Komunën e Podujevës për vitin 2017

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket këtij propozim plani, ne edhe në mbledhjen e KPF-së e kemi shqyrtuar dhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Sigurisht jeni në dijeni se Komunitat janë obliguara ta kenë Rregulloren përkatëse për transparencë e cila është hartuar dhe miratuar në bazë të Ligjit përkatës për transparencë, mirëpo përveç saj kërkohet që për çdo vit ta miratojnë edhe planin e veprimit për transparencë në të cilin mund të planifikohen të gjitha aktivitetet e bazuara në akte ligjore dhe nënligjore në fuqi. Andaj unë e hap debatin, nëse ka të lajmëruar për diskutim, nëse jo e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se me 29 vota për, 3 vota kundër dhe asnjë votë të përmbajtur u miratua Plani i veprimit për transparencë në Komunën e Podujevës për vitin 2017

5. Propozimi i vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm

z.Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë (DPKGJ), e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, para vetës keni propozim vendimin e Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën kadastrale Lupç i Poshtëm, vendi i quajtur Burgurdoll, pronë e cila është propozuar të jepet në shfrytëzim afatshkurtër për qëllime bujqësore, andaj nga Kuvendi i Komunës kërkohet të miratohet ky propozim paraprak në mënyrë që pastaj të bëhet shpallja publike dhe t'i mundësohet komisionit vlerësues të filloj me procedura përkatëse ligjore dhe nënligjore.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ne edhe në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar lidhur me këtë propozim, fjala është për një pronë për të cilën banorët e asaj ane janë në dijeni se aktualisht është e lirë dhe në të cilën vazhdimisht janë duke u hedhur ilegalisht mbeturina të ndryshme dhe gjendja e saj çdo herë e më shumë po bëhet e padurueshme. Ne si Kuvend mund të marrim vendim për miratim paraprak pastaj është komisioni përkatës i cili i zhvillon procedurat e parapara me ligj.

z.Bahri Blakçori, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të Kuvendit nga radhët e LDK-së e përkrahim këtë propozim vendim përkatësisht dhënien e asaj prone në shfrytëzim afatshkurtër, dhe mendojmë se është një hap i qëlluar nga ana e Komunës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, edhe në mbledhjen e KPF-së e kemi mbështetë këtë propozim vendim, mirëpo kam një kërkesë për kompetentët, në seancën e kaluar ne si Kuvend kemi marrë vendim për dhënien e dy pronave publike në shfrytëzim andaj kërkoj që ato vendime të funksionalizohen përkatësisht të zhvillohen procedurat përkatëse nga personat përkatës, qoftë nga Ekzekutivi i Komunës qoftë nga komisioni për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, në mënyrë që vendimi për billborde dhe vendimi për pronën në fshatin Orllan të publikohen në ankand dhe të ndërmerren të gjitha procedurat tjera me qëllim që të inkasohen të hyra komunale. Në këtë aspekt ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e PDK-së e mbështesim këtë propozim vendim dhe kërkojmë që të zhvillohen procedura të përshpejtuara dhe të zhduket ajo deponi e mbeturinave të ndryshme e krijuar në atë hapësirë. E them këtë ngase siç e përmenda ne i kemi marrë dy vendime para kësaj mbledhje por nga ana e kompetentëve nuk janë marrë hapa ende që ato prona të jepen në shfrytëzim ku si rezultat i kësaj kemi humbur edhe të hyra vetanake nga qiratë përkatëse.

z.Bahri Selimi, theksoi, sa i përket pronave komunale ne si Grup nga radhët e LVV-së mendojmë por edhe disa herë e kemi thënë që të gjitha ato prona komunale të cilat aktualisht janë të lira, të jepen në shfrytëzim, duke pasë parasysh se nga dhënia në shfrytëzim e atyre pronave Komuna gjeneron të hyra vetanake të cilat pastaj iu kthehen në investime dhe në interes të qytetarëve.

Konsideroj se ky propozim vendim duhet të mbështetet nga të gjithë sepse është e pëlqyeshme dhe e pranueshme për të gjithë. Gjithashtu e them se ka shumë prona tjera të ngjashme sikur kjo për të cilën po diskutojmë, të cilat janë të pashfrytëzuara andaj mendoj se do të ishte mirë që për të gjitha pronat e lira të diskutohet dhe të merret vendim për dhënie në shfrytëzim qoftë madje edhe me një kosto të vogël sepse është e hyrë vetanake dhe është më rrugës të jepen ne shfrytëzim se sa të lihen ashtu siç janë të pashfrytëzuara.

z.Nexhat Llumnica, theksoi, edhe ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e AAK-së e mbështesim këtë propozim vendim, për arsye se konsiderojmë që është në interesin e qytetarëve.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për diskutim, e hedh në votim këtë propozim vendim, duke pas parasysh edhe rekomandimet e arsyeshme të parafolësve që kishin për qëllim mbrojtjen e pronës.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua propozimi i vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm

6. Korrigjimi i gabimit teknik në Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore nr.01-320-32374, datë 10 prill 2014

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në mbledhjen e kaluar unë këtë çështje e paraqita në pikën të ndryshme gjithnjë duke menduar se kemi të bëjmë me një gabim teknik i cili duhet të korrigohet dhe i cili është i qartë për të gjithë, mirëpo ashtu siç u kërkuar të shtyhet për këtë seancë ashtu edhe kemi vepruar, andaj konsideroj se në materialin e dërguar janë të sqaruara të gjitha, konkretisht ka të bëjë me një gabim teknik në nenin 1 të Vendimit përkatës ku në vend të numrit të ngastrës kadastrale 764-3 të paraqitur në certifikatën përkatëse pronësore dhe në kopjen e planit, është shkruar gabimisht numri 746-3 i cili edhe ashtu nuk ekziston fare. Çështja në fjalë mund të verifikohet nga çdo kush. Edhe në mbledhjen e KPF-së kemi diskutuar për këtë dhe kemi konstatuar se kemi të bëjmë me një gabim teknik andaj edhe i kemi rekomanduar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. E hedh në votim këtë.

Pas votimit u konstatua se me 28 vota për, asnjë votë kundër dhe 3 vota të përmbajtura u përkrah propozimi për korrigjimin e gabimit teknik në Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore nr.01-320-32374, datë 10 prill 2014, përkatësisht bëhet korrigjimi i gabimit teknik në Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore nr.01-320-32374, datë 10 prill 2014, dhe atë: Numri i ngastrës kadastrale 746-3, sipas nenit 1 të Vendimit të lartcekur, korrigohet dhe bëhet 764-3.

7. Kërkesa - Propozim vendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ashtu siç jeni të informuar kjo pikë është futur si pikë shtesë dhe i është rekomanduar Kuvendit dhe në mbledhjen e KPF-së, gjithashtu sot në hyrje të kësaj mbledhje ju është shpërndarë edhe materiali përkatës. Kemi të bëjmë me një kërkesë të KEDS për t'i dhënë pronë në shfrytëzim në bazë të kërkesave të banorëve të asaj ane, andaj interesi në këtë çështje është drejtpërdrejt i atyre banorëve sepse ka investime, konkretisht ndërtim i një trafoje.

z.Haki Rudari, theksoi, unë edhe dje në mbledhjen e KPF-së kam abstenuar lidhur me këtë pikë për arsye se ka ardhur si propozim aty për aty, çështje tjetër është se ne disa herë e kemi thënë se Lëvizja Vetëvendosje vazhdimisht angazhohet për investime në të gjithë sektorët duke përfshirë edhe investimet e KEDS, mirëpo problemi dhe vërejtja jonë qëndron se vazhdimisht kësaj kompanie po i jepet në shfrytëzim pronë komunale falas pa kompensim, kompani e cila edhe ashtu është privatizuar falas në një farë mënyre, dhe po ashtu problemet janë të mëdha si me furnizimet etj, prandaj ne jemi kundër kësaj forme që Komuna t'i jep tokë publike falas KEDS-it, ne jemi për investime nga ana e KEDS-it, po jo në këtë formë të jepen prona komunale në shfrytëzim. Lëvizja Vetëvendosje apelon që këto probleme dhe këto gjëra të cilat po ndodhin vazhdimisht të mos ndodhin më. Tani dëshiroj ta ndërli dihi këtë me një çështje që ndoshta në fillim është dashur ta them, qytetarë të ndryshëm janë ankuar në Grupin tonë të LVV-së përkatësisht në zyrtarë tona kanë ardhur

kërkesa të cilët thonë se kanë bërë kërkesa për ndërtimin e një Xhamie në fshatin Llugë dhe gjithherë përgjigja e Komunës së Podujevës ka qenë se kemi pengesa ligjore, ndërsa kur është në pyetje KEDS aty për aty vijnë kërkesat, prandaj edhe njëherë e përsërisë që vërejtja jonë qëndron në atë që KEDS-ti po i jepet tokë falas ndërsa në të njëjtën kohë furnizimi me energji elektrike po vazhdon të mbetet i dobët. Është thënë që nëse ne nuk i japim pronë në shfrytëzim KEDS-it nuk bëhen investime, por unë konsideroj se nuk guxojmë të lejojmë të shantazhohemi nga askush siç është rasti i kompanisë KEDS e cila thotë ose na jepni pronë në shfrytëzim falas ose nuk investojmë, e them këtë për arsye se kur është privatizuar KEDS është lidh edhe marrëveshja për investime dhe këtu i posedoj edhe shumat e parapara për investime nga ana e KEDS, do të thotë se nuk është diçka që mund të na shantazhoj por është e drejtë e jona që të kërkojmë pagesë për shfrytëzimin e pronës nga KEDS, pra kjo është vërejtja jonë.

z.Kadri Avdiu, theksoi, nuk pata ndërmend të marrë fjalën rreth kësaj pike sepse ne këtë e sqaruam edhe në mbledhjen e KPF-së, mirëpo ne nganjëherë kur po bisedojmë për disa tema mendoj se po keqkuptohemi apo ndoshta dikush po e thotë, ndoshta jo me qëllim të keq, se duhet t'i vemi kushte KEDS-it për investime. Pikërisht unë mendoj se vendosja e një trafoje konkretisht në fshatin Dyz, meqë sot bëhet fjalë për atë pjesë, është një investim dhe nëse ky Kuvend ose banorët e atij fshati nuk lejojnë të ndërtohet – vendoset një trafo, është mos investim. Shumica prej nesh jemi në dijeni se në fshatin Dyz, madje unë e kam afër me fshatin ku banoj, kanë filluar kultivimi i produkteve bujqësisë sidomos i mjedrës, janë vendos edhe frigoriferët për ruajtjen e tyre, ndërsa me rrymën aktuale ku ende nuk janë vendosur shtyllat e reja dhe vazhdon furnizimi ende me kabllot ekzistuese ku rryma nuk e kalon 140 – 160 kv dhe ne mund ta marrim me mend se çfarë janë shpenzimet me një kapacitet të tillë. Andaj unë mendoj se në këto raste kur kemi të bëjmë me vetëm një operator dhe nuk kemi operator tjerë që paguajnë mjete financiare për shfrytëzimin e pronave publike, ashtu siç e ceku edhe Kryesuesi i Kuvendit ne duhet t'iu ndihmojmë qytetarëve sepse jemi në dijeni se si ballafaqohen ata me furnizim të energjisë elektrike sidomos në periudhat e vjeshtës, dimrit dhe në pranverë.

z.Nexhat Llumnica, theksoi, ne nuk jemi kundër investimit në fshatin Dyz, por probleme të njëjta kanë pothuajse të gjitha fshatrat e Komunës së Podujevës. Një kompani siç është KEDS me mbi 230 milion fond në vit, kërkon tokë falas për të investuar vetëm aty ku i konvenon asaj, kjo nuk ka arsye. Kemi fshatrat Bellopojë, Halabak, Shajkoc, Herticë dhe shumë vende tjera të cilat nuk kanë energji elektrike për tu shërbyer, përveç dritave madje edhe ato janë shumë të dobëta. Në momentin kur rryma është e dobët duhet të jemi në dijeni se dëmtohet qytetari. Kjo është një hajni e KEDS-it, ndërsa ne po ju krijojmë hapësirë KEDS-it që vetëm ku ata kanë dëshirë dhe ku ata i kanë njerëzit e vet të investojnë, kjo nuk do të thotë se jam kundër fshatit Dyz dhe investimeve atje, por duhet të kërkojmë që në çdo vend të investohet në këtë formë, pasi që KEDS ka buxhet të mjaftueshëm. Ne jemi në dijeni se si është privatizuar KEDS me 26 milion euro, 15 milion euro i ka marrë investime prej privatizimit deri në ndarjen e aseteve, kurse menjëherë i ka marrë 18 milion euro pas privatizimit, e që në total kapin shumë 36 milion euro, pra kjo kompani i ka fituar prej kompanisë publike 7 milion euro qysh në start ende pa filluar me punë, plus sot Komunitat e Republikës së Kosovës në përgjithësi, fatkeqësisht i jepin prona falas KEDS-it, ndërsa nuk e kushtëzojnë atë me investime në vende të domosdoshme. Unë besoj se toka bujqësore është shumë më e mirë në fshatin Bellopojë sesa në fshatin Dyz, ndërsa ka edhe shumë toka tjera të cila punohen por që pengohen për shkak të mungesës së

trafostacioneve apo investimeve kapitale ashtu siç e ka në marrëveshje KEDS-i për të investuar.

z.Kadri Avdiu, theksoi, parafolësi z.Nexhat Llumnica foli rreth fshatit Dyz dhe e potencoi se jemi kundër Dyzit – nuk jemi kundër Dyzit, mirëpo unë në diskutimin paraprak e përmenda fshatin Dyz dhe thash, meqë sot bëhet fjalë për atë pjesë - fshat, apo mund të jemi keqkuptuar. Sa i përket vendeve dhe fshatrave tjera ne kemi afërsisht 5 muaj që kur kemi miratuar një vendim me të cili i kemi dhënë pronë të tillë KEDS-it edhe në fshatin Bellopojë konkretisht për vendosjen e trafoje Lagjen Sfarça, dhe aktualisht në Bellopojë janë 5 trafo të vendosura por nuk do të thotë se nuk ka nevojë për tu zgjeruar ajo, mirëpo qëllimi im dhe i joni është që të mos marrim shembull ndonjë fshat sepse pastaj tingëllon sikurse ndokush është kundër e dikush për. Sa i përket asaj që u cek rreth privatizimit të KEDS-it, mendoj se niveli komunal nuk ka kompetencë të shqyrtoj privatizimin e KEDS-it sepse atë e ka bërë një institucion qendrorë, ndërsa ne nuk kemi kompetencë të merremi me atë sa dhe çka ka përfituar ajo kompani. Konsideroj se qytetarët duhet të jenë të kënaqur me furnizimin me energji elektrike, e që nuk janë, mirëpo pikërisht për atë që nuk janë edhe duhet të bëhen investime, ndërsa ne si Kuvend i Komunës mund të shfaqim pakënaqësi për ndonjë lëshim eventual që ka mund të jetë bërë në nivelin qendrorë, mirëpo nuk mund ta bartim dhe nuk mund ta marrim ato fajësi. Ne mund të diskutojmë vetëm për atë që është në kompetencë tonën si Kuvend dhe sa unë jam në dijeni se një gjë të tillë janë duke e bërë pothuajse të gjitha Komunitat e Kosovës sepse po të mos ishte interesi i qytetarëve nuk do ta bënim as ne, ndërsa tani në qoftë se ne votojmë kundër, qytetarët me siguri se do të thonë nesër që ne arritëm marrëveshje me KEDS për investim kurse këshilltarët e Kuvendit të Komunës të cilët i kemi votuar na e mohojnë këtë të drejtë dhe ne sot jemi pa korrent, pra kjo ishte ajo që desha ta thoja andaj të mos keqkuptohemi.

z.Nexhat Llumnica, theksoi, nuk desha të ketë keqkuptime në këtë kontekst, unë faktikisht jam në dijeni se gabimi është tek niveli qendrorë, dhe unë e potencova që ato gabime të mos i vazhdojmë edhe ne si Kuvend i Komunës sepse nuk do të thotë se duhet të vazhdojmë me të njëjtat gabime. Nuk është në interesin tonë që këto gjëra t'i ndajmë në zona elektorale por as në njerëz që mund të kenë zyrtarët e KEDS-it në fshatra të ndryshme, mirëpo kërkesa ishte që të investohet në çdo vend dhe kjo të kushtëzohet, fundja qytetarëve do t'i themi se ne e kemi respektuar ligjin ashtu siç KEDS e ka me kontratë, dhe ne nuk po kërkojmë t'i dëmtojmë qytetarët por po kërkojmë të zbatohet ligji dhe kontrata e KEDS-it sepse në kontratë shkruan se KEDS investon, por nuk shkruan që Komunitat duhet t'i falin pronë publike. Pra nëse në kontratë shkruan se ne duhet t'i falim pronë publike atëherë ne po e bëjmë një gjë të tillë, nëse jo atëherë ne po merremi vesh se si të veprojmë, pastaj për tu marr vesh, duhet të investohet në çdo vend në Komunën e Podujevës, por jo vetëm ku i konvenon KEDS-it.

z.Haki Rudari, theksoi, pa dashur të paraqitet këtu ndonjë subjekt politikë se gjoja është kundër investimeve sepse nuk do të ishte në rregull dhe nuk do të ishte e sigurtë, unë po e lexoj një deklaratë të cilën e kam nxjerrë në kuptimin zyrtarë, dhe atë, KEDS shkel kontratën e privatizimit, sipas marrëveshjes që kanë me Qeverinë e Kosovës, Kompania e cila ka fituar distribuimin dhe që është dashur të investoj 107.2 milion euro brenda periudhës 2013 – 2017, pra këto janë shifra zyrtare dhe lirshëm mund të gjenden sepse janë të dala nga marrëveshja, kurse tani pas 5 vitesh del që KEDS nuk i ka kryer investimet në tërësi sipas marrëveshjes dhe ka shkel kontratën e lidhur për mbetjen e punëtorëve në punë, do të thotë KEDS ka bërë dy gabime. Në vitin 2013 kanë qenë të lejuara 21 milion

euro për investime kurse janë investuar vetëm 16 milion euro, kjo do të thotë se qysh në vitin e parë ka mangu 5 milion euro. Pra as ne por as kolegu nga radhët e AAK-së nuk po themi se jemi kundër investimeve, por kërkojmë të bëhen investime ku duhet dhe si duhet dhe investime të rregullta, e jo të jepet tokë e komunës falas. Ne Grupi nga radhët e LVV-së gjithëherë kemi qenë shumë më transparent në këtë drejtim, e kemi përkrahur privatizimin por kemi qenë kundër asaj që pronat të jepen pa pare, dhe po të ishte vepruar kështu që nga fillimi, natyrisht që edhe problemi i kërkesave të banorëve kishte me qenë shumë në rregull. Edhe një herë po e përsërisë, nuk guxojmë të shantazhohemi dhe mos e hedhim fajin duke thënë se nuk do të ketë investime pastaj, sepse është kontrata e cila e obligon KEDS-in të investoj, prandaj në këtë drejtim mendoj se edhe ne këshilltarët e Kuvendit e kemi një lloj përgjegjësie sepse kemi obligimet tona të cilave duhet t'iu përmbahemi.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket privatizimit të KEDS, konsideroj se nuk është mirë të diskutojmë ne këtu sepse nuk është në kompetencën e Kuvendit të Komunës kjo çështje dhe nuk kemi pas dhe as nuk kemi qasje në ato gjëra, ashtu siç e tha edhe z.Kadri Avdiu. Po ashtu mendoj se ka organe tjera të nivelit qendrorë që i përcjellin investimet e KEDS-it.

Para vetës kemi një propozim për dhënie të pronës së paluajtshme të Komunës e që sipas ligjit kjo mundësi i është lënë Kuvendit të Komunës të vendos me apo pa kompensim. Jemi në dijeni se para dy-tri viteve patëm marr një vendim të tillë me të cilin figuronte pagesa – kompensimi, mirëpo siç jeni në dijeni edhe ju, nuk patën filluar punët nga ana e KEDS, pastaj në një takim të Kryetarit të Komunës me përfaqësuesit e KEDS, ju është kërkuar sqarime në lidhje me kompensimin e marrjes në shfrytëzim të pronave, mirëpo është thënë se KEDS nuk i paguan asnjë Komune kompensim të tillë. Andaj meqë kemi të bëjmë me investime në interes të banorëve të Komunës së Podujevës konsideroj se është e nevojshme miratimi i vendimeve të tilla.

Pas votimit u konstatua se me 27 vota për, asnjë votë kundër dhe 5 vota të përmbajtura u miratua propozimi i vendimit për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS.

8. Të ndryshme

z.Flakron Gashi, theksoi, unë kam pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit z.Faik Muçiqi, çfarë është duke ndodhur me trotuarin në fshatin Bajqinë kur kemi parasysh se trotuari afër shkollës në atë fshat ka vetëm rreth 2 vite e gjysmë që është rregulluar, kurse pastaj janë kryer punë nga një kompani por që më e keqja është se trotuaret nuk janë kthyer në gjendjen e mëhershme e që nuk besoj se ato trotuare do të mund t'i qëndrojnë edhe dimrit të ardhshëm ndërsa në pranverë do të jenë tërësisht të shkatërruara.

z.Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, edhe pse është përtej kompetencës tonë si Komunë unë megjithatë do të jap përgjigje rreth çështjes së ngritur nga parafolësi. Kemi të bëjmë me një pjesë të trotuarit në të cilin ka punuar Ministria e Infrastrukturës para dy – tri viteve, ndërsa tani janë duke u kryer punë nga Kompania Publike, ne kemi bërë raport – vërejtje se është duke u dëmtuar tërësisht ai

trotuar dhe kemi kërkuar nga kompania përkatëse punëkryese por edhe nga punëdhënësi që ta rregullojnë atë trotuar ose ta rikthejnë në gjendjen e mëparshme sepse vërtetë janë shkaktuar dëme të mëdha.

Në këtë aspekt kemi edhe telashe tjera me kompanitë KEDS dhe PTK të cilat kryejnë punë por bëjnë dëme tjera në vende të ndryshme, andaj në këtë aspekt keni të drejtë sepse kompanitë publike nuk janë duke i rikthyer në gjendjen e mëparshme qoftë asfaltin qoftë trotuaret etj.

z.Kadri Avdiu, theksoi, jemi në dijeni se kemi një vendim të mëparshëm të Kuvendit të Komunës me të cilin është caktuar 5 Maji Dita e Dëshmorëve dhe të Rënëve në Komunën e Podujevës si datë zyrtare, mirëpo nuk jam në dijeni dhe nuk është dhënë ndonjë informatë se a është ndërmarr diçka nga Ekzekutivi i Komunës për shënimin e kësaj date, andaj dëshiroj të informohemi se a është ndërmarrë diçka në këtë drejtim apo jo.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, jam në dijeni se drejtoresha e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit znj.Mrikë Thaqi është duke punuar diçka në këtë drejtim, mirëpo ne mund edhe ta vazhdojmë me praktikën e viteve të kaluara për shënimin e kësaj date.

znj.Mrikë Thaqi, drejtoresh e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit (DKRS), theksoi, sa i përket 5 majit Ditës së Dëshmorëve dhe të Rënëve në Komunën e Podujevës, se si DKRS jemi duke u përgatitur me aktivitete të ndryshme sportive dhe organizime të ndryshme duke përfshirë edhe vizita tek varrezat e Dëshmorëve dhe të Rënëve, por për organizime tjera sigurisht se do të njoftoheni me kohë.

z.Lutfi Rexhepi, theksoi, edhe në seancën e kaluar e kam pyetur Kryesuesin e Kuvendit dhe i njëjti më ka dhënë një përgjigje, por në Ligjin për vetëqeverisje lokale në mënyrë decitive kërkohet që çdo vite të kemi planin e punës së zyrës së prokurimit, që çdo vit të kemi planin e punës së auditorit të brendshëm. Po ashtu janë bërë disa muaj që propozim rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba komunale është vënë në diskutim publik dhe nuk është sjellë më në Kuvend për shqyrtim, andaj dëshiroj të pyes edhe një herë Kryesuesin e Kuvendit, a keni në plan që në këtë mandat t'i sillni këto gjëra i ceka, apo do ta përfundoni edhe këtë mandat sikur të gjitha mandatet tjera pa i trajtuar asnjëherë këto gjëra.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në mbledhjen e radhës do t'i jap përgjigjet parafolësit. Meqë nuk ka këshilltarë tjerë të lajmëruar për të marrë fjalën, unë me kaq e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11;20

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr.01-060/01-0034434/17

**Podujevë,
03 maj 2017**

**Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi**